

URDHËR
Nr. 535, datë 27.9.2019

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES TIP TË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET
BASHKISË DHE SHOQËRISË SË BASHKËPUNIMIT BUJQËSOR**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës, në nenin 20, pika 4, të ligjit nr. 24/2017, “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”, me propozimin e Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural,

URDHËROJ:

1. Miratimin e marrëveshjes tip të bashkëpunimit ndërmjet bashkisë dhe Shoqërisë së Bashkëpunimit Bujqësor (SHBB), sipas modelit bashkëlidhur.
2. Bashkitë dhe SHBB-ja, me miratim paraprak të ministrit, mund të parashikojnë në marrëveshje dispozita më specifike, me qëllim mirërrregullimin e marrëdhënies objekt i marrëveshjes, por pa rënë në kundërshtim me parashikimet e kësaj marrëveshjeje tip dhe të legjislacionit në fuqi.
3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural.
4. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA _____
Nr. _____, datë _____.____.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA E BASHKËPUNIMIT BUJQËSOR _____
Nr. _____, datë _____.____.2019

Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Bashkisë _____ dhe Shoqërisë së Bashkëpunimit Bujqësor (SHBB) _____

Bashkia, me seli në adresën _____, përfaqësuar nga kryetari z./znj. _____;

Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor _____, me seli në adresën _____, e cila është krijuar sipas ligjit nr. 38/2012, “Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor” dhe regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (_____), përfaqësuar nga administrator z./znj. _____ palët pjesëmarrëse (që në vijim do të quhen “Palë nënshkruese”), bien dakord dhe nënshkruajnë këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, si më poshtë vijon:

Neni 1
Objekti i marrëveshjes

Palët nënshkruese bien dakord të institucionalizojnë marrëdhëniet e tyre dhe të krijojnë një kuadër të favorshëm për bashkëpunimin, me qëllim realizimin e transferimit në përdorim të

infrastrukturës së ujitjes nga Bashkia_____ te Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor_____, si dhe të përgjegjësitë të shfrytëzimit dhe të mirëmbajtjes së kësaj infrastrukture.

Neni 2 **Baza ligjore**

Ligji nr. 24/2017, datë 9.3.2017, “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit” dhe ligjit nr. 38/2012, “Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor”.

Neni 3 **Afati i marrëveshjes**

Afati i kësaj marrëveshjeje është_____vite, me të drejtë rinovimi dhe fillon nga data e nënshkrimit të saj nga palët. Ky afat mund të ndryshohet përmes një marrëveshjeje me shkrim midis palëve.

Neni 4 **Të drejtat dhe detyrimet e Bashkisë_____**

Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, Bashkia_____ merr përsipër transferimin në përdorim të SHBB-ja_____ të infrastrukturës së ujitjes, sipas planimetrisë përkatëse dhe inventarit të detajuar, ku përfshihen, sipas rastit, burimi ujor (digë, vepër marrje në lumë/përrua/kanal, stacion pompimi), kanale ujitëse, vepra arti etj., që i bashkëlidhen kësaj marrëveshjeje. Ky transferim shoqërohet me mbajtjen e procesverbaleve të gjendjes teknike të infrastrukturës së transferuar.

Të vërë në dispozicion të SHBB-së_____ lejet mbi të drejtën e përdorimit të ujit për ujitje nga burimi ujor (nëse i transferohet si pjesë e infrastrukturës së ujitjes) të miratuara nga organet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.

Të bashkërendojë me SHBB-në_____, grafikët e furnizimit me ujë për ujitje, për rastet kur nuk është transferuar burimi ujor.

Të kontrollojë shfrytëzimin e infrastrukturës ujitëse (përfshi dhe sigurinë e digave) të transferuara, sipas kushteve teknike të projektimit.

Neni 5 **Të drejtat dhe detyrimet e SHBB-së_____**

1. Shfrytëzon dhe mirëmban infrastrukturën e ujitjes të transferuar në mënyrë të tillë që çdo anëtar i saj të marrë ujë në kohën dhe sasinë e kërkuar.

2. SHBB-ja_____, brenda zonës së vet të shërbimit, sipas planimetrisë/inventarit përkatës:

- a) pastron dhe mirëmban kanalet ujitëse;
- b) shfrytëzon dhe mirëmban burimet ujore;
- c) rehabiliton dhe rikonstrukton infrastrukturën e ujitjes;
- ç) mbikëqyr sigurinë e digave të rezervuarëve për ujitje dhe, kur është e nevojshme, në bashkëpunim me Bashkinë_____, kryen ndërhyrje emergjente të mirëmbajtjes apo të rehabilitimit për garantimin e sigurisë së tyre;
- d) merr në shqyrtim pasojat e veprimtarisë së vet në ekuilibrin natyror dhe merr masa për të parandaluar ose për të minimizuar çrregullimet ose dëmet në të;
- dh) merr masa për kontrollin e cilësinë e ujit për ujitje dhe të ujit që kullohet;

e) përmbush detyrat në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit dhe burimeve ujore;

ë) monitoron sasinë e ujit që përdor gjatë një viti;

f) përmirëson praktikën e menaxhimit të ujit për furnizim me ujë në mënyrë të barabartë të gjithë anëtarëve.

3. Për të gjitha rastet e ndërhyrjeve, sipas pikës 2, projektet e zbatimit për mirëmbajtjen, për rehabilitimin dhe sigurinë e digave duhet të miratohen më parë nga bashkia (për digat edhe nga Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha).

Neni 6

Zgjidhja e Marrëveshjes

Marrëveshja përfundon me përfundimin e afatit të përcaktuar në nenin 3 të kësaj marrëveshjeje.

Marrëveshja mund të zgjidhet përpara afatit me kërkesë të SHBB-së _____, duke njoftuar Bashkinë _____, me shkrim, të paktën një muaj përpara.

Marrëveshja mund të zgjidhet nga Bashkia _____, në rast se nuk respektohen detyrimet sipas nenit 4, të kësaj marrëveshjeje.

Në rast se, për shkak të arsyeshme, Bashkia _____ vendos të zgjidhë këtë marrëveshje përpara afatit, duhet të njoftojë me shkrim SHBB-në, të paktën 30 ditë përpara.

Neni 7

Ndryshime

Çdo përshtatje, modifikim ose ndryshim i tekstit të kësaj marrëveshjeje, që propozohet nga palët nënshkruese, kërkon aprovimin me shkrim të palëve.

Neni 8

Mosmarrëveshjet

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve që mund të lindin ndërmjet palëve, për sa i përket zbatimit të kësaj marrëveshjeje, do të arrihet me mirëkuptim dhe nëpërmjet diskutimeve mes palëve nënshkruese. Në rastin kur palët nuk arrijnë të zgjidhin mosmarrëveshjet me mirëkuptim, i drejtohen gjykatës administrative kompetente.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi datën e nënshkrimit të saj dhe mbahet në katër kopje me vlerë të njëjtë ligjore, në gjuhën shqipe, nga të cilat, dy kopje mbahen në Bashkinë _____ dhe 2 kopje mbahen nga SHBB-ja _____.

Sa më sipër u lexua, u aprovua dhe u nënshkrua nga palët, në datën _____. 2019.

Për Bashkinë _____

Kryetari

Z./znj. _____

Për Shoqërinë e Bashkëpunimit Bujqësor

Administratori

Z./znj. _____